



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Komunitete, mbajtur më dt. 18.7.2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Tria Kasumi Berisha, Kimeta Shok.

Munguan: Adnan Ajeti, Faton Marolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Klaudia Mulla - zyrtare për komunitete në ZKKK, Qefsere Berisha Veseli - zyrtare në ZKKK, përfaqësuesit e KFOR-it, Arianita Beqa Rraci - UNMIK, Fatlinda Hoxha - zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor i punës së Komitetit për Komunitete;
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave brenda gjashtë muajve;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor për punën e ZKKK-ës;
5. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë z. Izet Sadiku të na informojë lidhur me:
 - a) ofrimi i shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë;
 - b) zbatimin e programit të vaksinimit për fëmijët nga komunitetet rom dhe ashkali;
6. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve znj. Donika Çeta të na informojë lidhur me planin e punës së drejtorisë për vitin 2024;
7. Raporti i ZKKK-ës për muajin qershor 2024;
8. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre;
9. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Faqe 1 nga 5

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KK-së
Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Shqyrtimi i dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor i punës së Komitetit për Komunitete
Mirsada Behluli – shtroi pyetje se a ka dikush të thotë diçka lidhur me raportin gjashtëmuor të punës së Komitetit për Komunitete.

Nenad Miladinoviç: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se vetëm dua t'ju falënderoj për këtë raport, në tërësi e ka përfshirë të gjithë punën tonë, ndoshta është pak i zgjatur, por ka mundur të jetë edhe më i shkurtër, mirëpo është për çdo lëvdatë.

Njëzëri u miratua Raporti gjashtëmuor i punës së Komitetit për Komunitete.

Pika e tretë

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave brenda gjashtë muajve

Klaudia Gega Mulla – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se nuk është që kemi pasur ndonjë ankesë apo kërkesë, pasi që të gjitha ankesat dhe kërkesat kalojnë përmes komitetit, kështu që nuk kemi pasur diçka.

Pika e katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit gjashtëmuor për punën e ZKKK-ës

Klaudia Gega Mulla – tha se propozoj që pika e katërt e rendit të ditës, **Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor për punën e ZKKK-ës**, të hiqet sot nga rendi i ditës e të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Pika e pestë

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë z. Izet Sadiku të na informojë lidhur me: a) ofrimi i shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë;
b) zbatimin e programit të vaksinimit për fëmijët nga komunitetet rom dhe ashkali.

Fatlinda Hoxha: - lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhe pyetjeve të shtruarra tha se kujdesi shëndetësor ofrohet njëjtë për të gjithë njerëzit, pavarësisht moshës, gjinisë, statusit social, ekonomik dhe të tjera (është plan i vitit 2023 -2024). Ajo në vazhdim tha se komunitetet janë të ftuara në mbajtjen e fushatave vetëdijësuese dhe aktiviteteve tjera siç janë fushata dhe punëtoritë e ndryshme, të cilat

mbahen nga profesionistët shëndetësorë, ashtu siç është përcaktuar edhe me planin e veprimit, temat janë të caktuara në baza vjetore. Ndërsa sa i përket vaksinimit tha se edhe në vaksinim janë të përfshirë të gjithë, qytetarët e kryeqytetit, pavarësisht gjinisë, racës, statusit ekonomik etj., të gjithë qytetarët përfshihen në planin e vaksinimit pavarësisht a është ky plan i zbatueshëm në shkolla apo në Qendrat e Mjekësisë Familjare.

Mirsada Behluli: -duke iu drejtuar znj. Hoxha tha se do t'ju kisha lutur në emër të anëtarëve të komunitetit, të cilët nuk e din gjuhën shqipe mjaftueshëm, siç janë p.sh. komuniteti goran, komuniteti boshnjak, komuniteti serb, malazez dhe kroat dhe të tjerë, që kur i drejtohen institucioneve shëndetësore, t'ju ndihmohet duke i orientuar te kuadri më i vjetër mjekësor i cili e njeh gjuhën, ashtu që kishte me ju ndihmuar shumë dhe nuk do të kishin pengesa në komunikim.

Nenad Miladinoviç: - sa i përket bashkëpunimit me këtë Drejtori tha se kam pas rast edhe më përpara të bashkëpunoj me këtë drejtori, kanë qenë shumë korrekt, kur është në pyetje ndihma për të sëmurit, shumë herë kam pasur rast t'i drejtohem edhe vetë doktoreshës gjithmonë më ka pritur mirë dhe në kufijtë e saj të mundësisë më ka dal në ndihmë. Në fund pyeti se a ekziston akoma programi i njehershëm, cilat kategori mund t'i përkasin dhe sa është vlera e ndihmës së përhershme.

Fatlinda Hoxha: - lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Miladinovic tha se subvencionet vazhdojmë me ju dhënë qytetarëve të kryeqytetit të Prishtinës, kurse janë pranuar mbi 5000 kërkesa dhe komisioni aktual i ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, i ka kategorizuar në bazë të kategorisë dhe në bazë të terapisë, vazhdon të jetë i hapur për të dërguar kërkesat dhe komisioni i vlerëson në vazhdimësi, ndërkaq dokumentet e nevojshme janë: vërtetimi i bashkësisë lokale, konfirmimi i bankës, kopja e letërnjoftimit dhe raporti mjekësor i 6 - mujorit të fundit.

Klaudia Gega Mulla: - lidhur me bashkëpunimin me drejtorinë përkatëse tha se bashkëpunimi jonë është qe sa vite, ndërsa sa i përket shërbimeve që komunitetet i marrin, është njëra ndër drejtoritë më përgjegjëse mundem me e thënë dhe që na janë përgjigj në çdo formë, çdo pjesë dhe me shpejtësinë më të madhe, sidomos Fatlinda është marrë me organizimin e komuniteteve me planin lokal të veprimit për rom, ashkali, egjiptian, të Komunës së Prishtinës. Më vjen keq sot se nuk janë prezent përfaqësuesit e komunitetit rom, ashkali, egjiptian, ku dhe e kam një vërejtje për shkak se anëtarët e tyre nuk marrin pjesë në këto fushata, të cilat organizohen me qaq përkushtim nga stafi shëndetësor, e të cilat kanë implikime buxhetore nga komuna. Në këtë rast ju bëj thirrje përfaqësuesve të komuniteteve që të jenë pjesëmarrës në fushatat vetëdijësuese.

Pika e gjashtë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Parqeve znj. Donika Çeta të na informojë lidhur me planet e punës së drejtorisë për vitin 2024

Për shkak të mosmundësisë së pjesëmarrjes së drejtoreshës së drejtorisë përkatëse në takim, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njërin nga mbledhjet e radhës.

Pika e shtatë

Raporti i ZKKK-ës për muajin qershor 2024

Faqe 3 nga 5

Klaudia Gega Mulla: - sa i përket raportit mujor të Zyrës për komunitete, tha se janë implementuar të gjitha aktivitetet e parapara në planin e punës, aktivitetet tjera që janë të paparashikueshme janë mbajtur trajnime të ndryshme, besoj se të gjithë e keni lexuar dhe ajo çka është me rëndësi dua t'ju njoftoj se organizata IOM e ka zgjatur afatin e aplikimit për komunitete deri me dt. 31.7.2024, në ç'rast ju bëj thirrje si herën e kaluar, që të aplikoni sa më shumë dhe t'i njoftoni anëtarët e komuniteteve, të aplikojnë për projekte individuale ose përmes OJQ-ve, kurse deri më tani 2, 3 persona nuk kanë aplikuar më tepër dhe kanë thënë se nga Komuna e Prishtinës, kanë aplikuar më së paku, sidomos anëtarët femra.

Mirsada Behluli: - duke iu drejtuar të pranishmëve tha se sa i përket njoftimit për grante dhe projekte, nëse nuk keni pasur mundësi të aplikoni vetë mund të paraqiteni për ndihmë tek Zyra për komunitete dhe ata do t'ju ndihmojnë.

Klaudia Gega Mulla: - tha se javën e kaluar kemi pasur një takim me përfaqësuesin e organizatës IOM dhe përfaqësuesin e komunitetin rom, ashkali, kanë ardhur i kanë plotësuar aplikacionet, kështu që ne si ndërmjetësues në mes tyre i kemi asistuar duke ju ndihmuar atyre për të aplikuar.

Pika e tetë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësinë e tyre

Nanad Miladinoviç:- shtroi shqetësimin lidhur me rastin kur një qytetar shqiptar nga Bërnica ka sulmuar qytetarin nga komuniteti serb z. Gjoshiq dhe i ka shkaktuar lëndime të rënda, ku e gjithë kjo ka ndodhur në një market. Ai mes tjerash tha se unë do të flas vetëm për atë që kam informatë të saktë, personalisht nuk kam qenë prezent, por po e them atë që e di. I gjithë rasti është incizuar nga kamerat ku dhe inspektorati policor ka bërë padi ndaj disa pjesëtarëve të policisë, të cilët fatkeqësisht, ndaj babait të personit të sulmuar Gjoshiçit, kanë përdorur dhunë, unë nuk e di se si ka ardhur deri te kjo dhe qysh ka ardhur. Realisht nuk e di vetëm se e di se hetimet janë duke vazhduar, policia është duke punuar në këtë rast dhe jemi në pritje. Mendoj se marrëdhëniet ndëretnike nuk duhet të shkatërrohen, ky është një rast që patjetër duhet të dënohet dhe besoj se organet kompetente duhet të kryejnë punën e tyre.

Mirsada Behluli: - duke u ndërlidhur në shqetësimin me rastin e lartpërmendur tha se pa marrë parasysh se çka ka ndodhur në Bërnicën e Poshtme dhe besoj se pajtoheni të gjithë se kudo që ndodh dhunë, ne e gjujmë dhe jemi kundër asaj dhe komuniteti njëzëri e kundërshton dhunën dhe problemet ndaj dhunës, ku organet kompetente duhet të kryejnë punën për të mos ardhur te këto situata. Prandaj edhe njëherë shprehi shqetësimin lidhur me rastin dhe uroj që mos të përsëriten më këso kacafytje.

Pika e nëntë

Të ndryshme

Mirsada Behluli: - në të ndryshme, tha se herën e kaluar kemi planifikuar që të shkojmë për një vizitë te Zyra për komunitete në Zyrën e kryeministrit, gjë që nuk është realizuar, prandaj a jeni të interesuar që për muajin shtator të realizojmë vizitën e planifikuar.

Ajo mes tjerash tha se Arianita na ka kërkuar listën e nxënësve të komunitetit boshnjak, këtë listë do t'ju jap më vonë. Për shkollat fillore dhe të mesme, ka kërkuar edhe për komunitetin turk dhe komunitetet tjera.

Klaudia Gega Mulla: - tha se a mund të dimë arsyen?

Arianita Beqa Rraci: – tha se na duhet vetëm numri sa janë nëpër shkolla, që nëse kemi diçka për t'i ndihmuar, atëherë të kemi numrin e saktë të nxënësve dhe cilit komunitet i përkasin.

Klaudia Gega Mulla: - raportin e fundit që kemi zhvilluar vizita nëpër shkolla, me shifra të sakta të nxënësve, të cilat janë prezantuar në komitet, nuk ka asnjë problem që ato me i vendosur në një databazë.

Mirsada Behluli: – sa i përket takimit të ardhshëm do të jemi në kontakt me Linden dhe do të jeni të informuar për datën e takimit.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

